



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Real Estate Kosovo" SHPK.
- II. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela nr. 197-0, sip. 4147 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914066-00197-0, dhe parcela 198-0, sip. 4814 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914066-00198-0, Zona kadastrale, Sofali, në pronësi të "Real Estate Kosovo", SHPK, me destinim pejsazh i mbrojtur sipas vendimit nr. 01.031-311318, dt. 22.12.2016. Kurse prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim ka këto karakteristika: pjesa e parcelës nr. 00153-1, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00153-1, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Mati 3", 01, nr. 35-133, dt. 29.03.2007.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për arsye se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, anadaj për t'u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijnë nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 00153-1, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00153, Zona kadastrale Matiçan, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Mati 3", nr. 01.35-133, dt. 29.03.2007.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Pronari i pronës private, sipas kërkesës nr 13-464/01-103387/21, dt. 07.06.2021, ka kërkuar që të kompensohet për pronën private e cila shfrytëzohet për interes publik, gjegjësisht parcela nr. 197-0, sip. 4147 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914066-00197-0, dhe parcela 198-0, sip. 4814 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914066-00198-0, Zona Kadastrale, Prishtinë, në pronësi të “Real Estate Kosovo” SHPK, me destinim “Pejsazh i mbrojtur”, sipas vendimit 01. nr. 031-311318, dt. 22.12.2016.

Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale me pronën private, të cekur në pikën II, është bërë për arsyet se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për t’u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijnë nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 00153-1, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00153, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues “Mati 3”, 01, nr. 35-133, dt. 29.03.2007.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112339/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

